



O Njeri..

Kush je ti?

Prej nga vjen?

Për ku je nisur?

Këto pyetje duhet secili prej nesh t'ia bëjë vetes.. Duhet të jetë i vetëdijshëm për veprimet e tij, për sjelljet e tij, duhet të mbajë përgjegjësi për çdo fjalë apo veprim të kryer..

Kush jemi ne?

Kur na bëhet kjo pyetje, ne përgjigjja e parë që kthejmë është emri ose tregojmë se fëmijët e kujt jemi.. Por, kush jemi ne në të vërtetë...? Ne jemi ato krijesa që Allahu (xh.sh) i ka krijuar në mënyrën më të përsosur, jemi këto qenie të cilat jemi krijuar nga balta dhe Ai na ka dhënë formën më të përsosur.. Allahu (xh.sh) në Kur'anin famëlartë thotë:

"Për Allahun, Ne krijuam njeriun prej një ajke (lëngu), e një balte. Pastaj atë (ajkë - baltë) e bëmë (e shndërruam) pikë uji (farë) në një vend të sigurt. Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, dhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është All-Ilahu, më i miri Krijues!" (23:12-14)

Nëse vërejmë me vëmendje formën e krijimit tonë është vërtet një mrekulli. Pra ne, këto qenie,

të krijuara prej baltës, kaq të dobëta përpara një Krijuesi të madh.. të mos jemi ne në gjendje të falënderojmë krijuesin tonë..? Subhanallah! O njeri, ktheje kokën pak pas e kujtohu, ulu arsyeto, ji prej falënderuesve.. O njeri falëndero për të gjitha të mirat që Ai t'i ka falur..

Prej nga vijmë?

Nëse e bëjmë këtë pyetje, cila do të ishte përgjigja jonë? Natyrisht, secili kishte për të kthyer një përgjigje fare të thjeshtë, do të përgjigjej me shtetin apo qytetin prej nga vjen...

Por në të vërtetë ne jemi pasardhës të Ademit (a.s.) dhe Havasë.. Allahu (xh.sh) në Kur'an thotë:

"O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre." (49:13)

Në një ajet tjetër Kur'anor thuhet:

"Ai është krijues i qiejve e i tokës. Ai nga lloji juaj krijoi për ju bashkëshorte, edhe nga kafshët krijoi çifte, ashtu që t'ju shumojë." (42:11)

Pra, nga këto ajete të Kur'anit famëlartë kuptojmë që secili prej nesh e ka prejardhjen prej një mashkulli dhe një femre, nëpërmjet së cilës Allahu (xh.sh) e bëri të mundur shumimin midis tyre.

Për ku jemi nisur?

Mbërritëm dhe te pyetja e tretë... O njeri... Cila kishte për të qenë përgjigja për këtë pyetje?!

Pak e dinë rrugën se për ku janë nisur, pak e dinë cakun e kësaj jete, e kësaj dynjaje të shkurtër, e cila s'është gjë tjetër veç se një sprovë, ku me veprat që kemi për të bërë kemi për t'u marrë në llogari, kemi për të dalë para Krijuesit tonë, dhe kemi për t'u marrë në pyetje. Allahu (xh.sh) në Kur'an thotë:

"Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju sprovuar se cili prej jush është më vepërmirë." (67:2)

Në një ajet tjetër thuhet:

"Ai e filloi krijimin e pastaj e përsërit atë për t'i shpërblyer me të drejtë ata që besuan dhe bënë vepra të mira." (10:4)

Pra, nga këto ajete Kur'anore vërejmë që ne jemi krijuar për një qëllim, dhe ai është veprimi i punëve të mira, i atyre të hajrit, i kryerjes së atyre që na janë bërë obligim, shmangia nga ato gjëra të dyshimta, dhe mbështetja në Allahun e Plotfuqishëm..

E lusim Allahun e Madhëruar të na shtojë imanin tonë dhe të na bëjë banorë të Xhennetit Firdeus, e lusim që të na largojë nga ato veprime të cilat na çojnë në mërzitjen e Krijuesit Tonë...(amin)...

Rejhana Çerkezi